



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3606 Prot.

Tiranë, më 29.12 2023

URDHËR

Nr. 146 datë 29.12 2023

“PËR

**MIRATIMIN E STRATEGJISË SË RISKUT DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR
MINIMIZIMIN E RISQEVË NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 204, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 5, neni 8, pika 8, gërma a, neni 27, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025.
2. Miratimin e planit të veprimit për minimizimin e risqeve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij Urdhri.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

**STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË
2023 - 2025**

1. Hyrje

1.1 Çfarë është Risku dhe Menaxhimi i Riskut

Risku, përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo kërcënim negativ i veprimeve dhe i ngjarjeve. Ai është probabiliteti i ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar (pozitive ose negative), që do të kishte impakt në përmbushjen e objektivave të një njësie.

Kërkesa për hartimin e dokumentit/strategjisë së menaxhimit të riskut dhe përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut, përcaktohen në nenet 10 dhe 21 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Në nenin 21 të këtij ligji, përcaktohet koncepti i menaxhimit të riskut dhe konkretisht:

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

1.2 Strategjia e Riskut

Si çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (qendrore, vendore, institucion i pavarur), edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), duhet të ketë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në tre vjet), si dhe sa herë, kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

- a) Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e institucionit ndaj menaxhimit të riskut e përcaktuar nga titullari dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të ILD. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e menaxhimit të riskut miratohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve për njohje dhe zbatim.

- b) Strategjia e riskut të ILD përcakton në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollin e risqeve (të ashtuquajturit zotërues të risqeve), trajtimin e risqeve në nivelin strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, si edhe kriteret për matjen e riskut.

Strategjia e riskut hartohet në përfaqje me dokumentat e politikave sektoriale dhe kombëtare.

- c) Në strategjinë e riskut përcaktohet dhe oreksi i riskut, i cili lidhet me nivelin e riskut që lejohet, në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të ILD, në çdo kohë, para se të vendoset

nëse duhet të ndërhyhet. Oreksi i riskut ndikohet nga mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm i kontrollit, nga burimet njerëzore, nga sistemet e punës dhe nga politikat.

1.3 Qëllimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut

Një menaxhim i mirë i riskut i'u mundëson strukturave sipas hierarkisë dhe grupeve të interesit, rritjen e konfidencës në mirëqeverisjen e institucionit dhe mundësinë për ofruar shërbimet.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për mision forcimin e mekanizmave institucionalë në matjen e performancës së sistemit për cilësinë dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së subjekteve të hetimit disiplinor në ushtrimin e detyrës nga njëra anë dhe motivimin e rritjen e besimit të publikut dhe organeve që ligji u njeh të drejtën e paraqitjes së ankesave ndaj sistemit gjyqësor, nga ana tjetër.

Përmbushja e misionit/qëllimit të institucionit, përkatësisht përmbushja e objektivave dhe detyrave të programuara, karakterizohet nga pasiguria, e cila është kërcënuese për arritjen e suksesit.

2. Komponentët e Menaxhimit të Riskut

Sfida kryesore në menaxhimin e riskut është identifikimi fillestar i riskut, analiza e tij dhe zhvillimi i procesit të menaxhimit të riskut, gjithashtu rishikimet e vazhdueshme dhe përmirësimi në vijimësi i menaxhimit të riskut.

Komponentët e menaxhimit të riskut, përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:



2.1 Identifikimi dhe Dokumentimi i Riskut

Pas identifikimit të të gjitha objektivave strategjike, programore dhe operacionale, menaxherët duhet të identifikojnë të gjitha risqet që lidhen me secilin objektiv (d.m.th ngjarjet që mund të kërcënojnë arritjen e objektivit, përfshirë mospërfitimin nga të gjitha mundësitë që jepen).

Identifikimi i risqeve është një proces që përfshin gjetjen, njohjen dhe përshkrimin e risqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, si dhe identifikimin e shkaqeve dhe pasojave të mundshme. Gjatë identifikimit të risqeve, duhen identifikuar ngjarjet më të mundshme që mund të dëmtojnë punën.

Risku duhet të identifikohet dhe të njihet si një mundësi reale nga shumica e vlerësuesve (çfarë është e mundur të ndodhë në realitet dhe masat që duhen marrë ndaj tij).

Duhet të identifikohet risku që vjen nga burime të jashtme, ku përfshihen kushtet ekonomike dhe politike, dispozitat legjislative dhe rregullatore, kushtet ambientale dhe ngjarjet natyrore, furnitorët e ndryshëm etj. Gjithashtu, risqet që vijnë nga burime të brendshme, ku përfshihen burimet njerëzore, financa dhe çështjet financiare, marrëdhëniet e punës, sistemet e informacionit dhe komunikimit, si edhe siguria e jashtme.

Gjatë identifikimit të risqeve duhet bërë dallimi midis riskut ekzistues dhe riskut të mbetur:

- ✓ Risku ekzistues është ekspozimi ndaj një risku specifik, para ndërmarrjes së veprimeve për menaxhimin e tij.
- ✓ Risku i mbetur është ekspozimi ndaj një risku specifik, pas ndërmarrjes së veprimeve për menaxhimin e tij dhe supozimit se veprimi i ndërmarre ka qenë efektiv.

Për të gjitha risqet e identifikuar do të caktohen zotëruesit përkatës, të cilët kanë përgjegjësinë, pasi risqet menaxhohen dhe monitorohen gjatë gjithë kohës. Zotëruesi i riskut, në përputhje me përgjegjësitë për menaxhimin e tij, duhet të ketë autoritetin e mjaftueshëm për të siguruar që risku menaxhohet në mënyrë efektive.

Risku është i pashmangshëm, ndaj duhen ndërmarrë veprime për të menaxhuar riskun në një mënyrë ku duhet të justifikojë një nivel tolerance. Sasia e riskut që gjykohet të jetë e tolerueshme dhe e justifikuar quhet “risk i pranuar”.

Koncepti i riskut të pranuar është thelbësor në arritjen e menaxhimit efektiv të riskut dhe duhet konsideruar para se të shikojmë mënyrën e adresimit të risqeve. Koncepti mund të shihet nga këndvështrime të ndryshme, në varësi të faktit nëse risku (pasiguria) konsiderohet si kërcënim apo si mundësi.

Risku i identifikuar, duhet të dokumentohet në Regjistrin e Riskut, formati i të cilit është i standartizuar dhe pjesë përbërëse e kësaj strategjie.

Regjistri i Riskut duhet të publikohet dhe të jetë i disponueshëm për të gjithë stafin e ILD.

2.2 Analiza dhe Vlerësimi i Riskut

Procesi i analizimit dhe vlerësimit të riskut është një gjykim që mbështetet në ekspertizën dhe përvojën e vlerësuesit/ve të riskut dhe nivelin e informacionit në dispozicion në kohën e shqyrtimit. Risku duhet të analizohet dhe vlerësohet, si edhe të ketë përparësi në lidhje me objektivat e ILD, të përcaktuara në zbatim të strategjisë institucionale dhe të lidhura ngushtë me procesin e buxhetimit afatmesëm.

Në vlerësimin e risqeve ka tre parime të rëndësishme:

- Të siguruarit të një procesi të strukturuar qartë në të cilin merren parasysh si mundësia e ndodhjes edhe ndikimi për secilin risk,
- Regjistrimi i vlerësimit në mënyrë të tillë që lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioritetëve të riskut,
- Dallimi i qartë midis riskut ekzistues dhe riskut të mbetur.

Ndaj, drejtuesit e të gjitha niveleve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të vlerësojnë secilin nga risqet e identifikuar në drejtim të mundësisë së ndodhjes dhe të ndikimit mbi objektivat, përsa vijon:

- a. Mundësia që risku të ndodhë, lidhet me probabilitetin/gjasat që një ngjarje e pafavorshme të ndodhë, nëse nuk ka aktivitete kontrolli që do të parandalonin, ose do të pakësonin riskun, apo kur aktivitetet nuk janë të mjaftueshme.

Mundësia që risku të ndodhë duhet të vlerësohet për secilin nga risqet e identifikuar me 3 (tre) shkallë, përkatësisht “i lartë/i mesëm/i ulët”,

- b. Ndikimi është efekti që një ngjarje e pafavorshme/e padëshirueshme do të kishte në institucion, nëse ngjarja do të ndodhte vërtet. Një efekt i tillë do të ishte ose një lloj dëmi, ose një lloj mundësie e humbur. Nëse është e mundur, efekti duhet të përlogaritet në formë sasiore. Minimalisht, efekti duhet të përshkruhet në mënyrë aq konkrete, sa të tregojë rëndësinë e riskut.

Ndikimi duhet të vlerësohet me 3 (tre) shkallë.

- c. Vlerësimi i secilit risk duhet të rishqyrtohet të paktën një herë në vit, por edhe më shpesh, në varësi të ndikimit që ka në realizimin e objektivave.
- d. Gjatë vlerësimit të riskut duhen marrë parasysh raporti i kostos për aktivitetet e kontrollit që do të ndërmerren ndaj përfitimeve, lidhur me reduktimin e riskut.

Si pasqyrohet më sipër, ndikimi i riskut ndahet në 3 (tre) kategori, “I Lartë/i Mesëm/i Ulët”, duke rezultuar në një matricë risku “3x3”. Matrica e riskut paraqet renditjen e risqeve të mbetura, pas zbatjes së mundur nga kontrollet ekzistuese.

Ajo përcakton zonat e riskut, me peshë dhe impakt të ndryshëm, si më poshtë:

Mundësia e ndodhjes	I Lartë	6	3	1
	Mesatar	8	4	2
	I Ulët	9	7	5
		I Ulët	Mesatar	I Lartë
	Ndikimi			

Sa më pak të pranueshëm dhe sa më pak të ekspozuar të duam të jemi ndaj riskut, aq më i lartë do të jetë prioriteti për adresimin e riskut.

Risqet me prioritet më të lartë (risqet kyçe) duhet të shihen me vëmendje rregullisht nga Grupi i Menaxhimit Strategjik të ILD (GMS). Prioritetet për risqe të veçanta do të ndryshojnë me kalimin e kohës, pasi risqet specifike të jenë adresuar, dhe për pasojë ndryshojnë edhe prioritetet.

2.3 Reagimi dhe Trajtimi i Riskut

Reagimi ndaj riskut do të thotë marrja e masave për të ulur mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin e riskut deri në bërjen e tij zero (0). Qëllimi i përgjigjes ndaj riskut është të kthehet pasiguria në përfitim për Institucionin, duke kufizuar kërcënimin dhe duke shfrytëzuar mundësitë. Çdo veprim i ndërmarrë nga ILD për të adresuar risqet është pjesë e atij që quhet “Kontroll i Brendshëm”.

Reagimi ndaj çdo risku duhet të shqyrtohet të paktën një herë në vit. Reagimi ndaj çdo risku mund të jetë: **tolerimi ndaj tij, trajtimi i tij** (nëpërmjet kontrolleve parandaluese, korrigjuese, drejtuese ose dalluese), **tranferimi i tij dhe/ose përfundimi i riskut**.

Përgjigja përfundimtare do të regjistrohet në Regjistrin e Riskut.

Reagimet/përgjigjet e mundshme ndaj riskut janë si më poshtë:

a. Trajtimi me qëllim kufizimin ose pakësimin e riskut

Ky është reagimi/përgjigja më e përhapur që aplikohet nga gjithë menaxherët. Kjo për faktin se, ndodh shumë rrallë që risku të shmanget/transferohet plotësisht. Prandaj, duhen planifikuar aktivitete kontrolli që japin një garanci të arsyeshme se risku do të kufizohet në parametra të pranueshëm, në varësi të rëndësisë së riskut dhe kostove të kontrolleve.

Risqet që trajtohen në këtë formë duhet të monitorohen rregullisht.

b. Transferimi i riskut

Stafi menaxhues i ILD mund të vlerësojë riskun si tepër të lartë, që duhet “transferuar” në një njësi apo institucion tjetër. Mënyra klasike e transferimit të riskut është sigurimi/siguracioni. Në rastet e sigurimit (përfshirjes së kompanive të sigurimit), do të ketë kosto shtesë, por treguesi “impakti/ndikimi i riskut” do të ulet ndjeshëm.

Një mënyrë tjetër për transferimin e riskut është lidhja e marrveshjes me një njësi/institucion tjetër, tek i cili tranferohet aktiviteti, nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët të palëve.

c. Tolerimi i riskut

Është një lloj reagimi/përgjigje e mundur vetëm nëse risqe të caktuara kanë një ndikim të kufizuar (të papërfillshëm) në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjikë të ILD, ose kur kostot për marrjen e masave nuk janë në përpjestim të drejtë me përfitimet e mundshme. Në një rast të tillë, tolerimi mund të ishte një përgjigje ndaj riskut. Megjithatë, risqe të tilla, duhen monitoruar gjatë gjithë kohës, pasi ekziston mundësia që disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, mund të ndikojnë në rritjen e shkallës së mundësisë së ndodhjes së riskut, apo të ndikimit të tij, duke e çuar riskun apo risqet në një nivel/kategori më të lartë.

d. Ndërprerja e riskut

Disa risqe mund të pakësohen ose të kufizohen në nivele të pranueshme, vetëm nëse mbyllet aktiviteti. Mosmarrja e masave/veprimeve mund të përbëjë një rrezik në vetvete, sepse qëllimet dhe objektivat e njësisë nuk mund të arrihen.

Në sektorin publik, mundësitë e ndërprerjes së riskut janë shumë të kufizuara, pasi në shumicën e rasteve qëllimet strategjike të institucioneve përfshihen/përcaktohen në programet e qeverisë.

2.4 Monitorimi dhe raportimi i riskut

Monitorimi ndihmon për të ndjekur procesin, nëse risqet janë menaxhuar me sukses, pra nëse aktivitetet/veprimtaritë e kontrollit i kanë minimizuar risqet korresponduese, si edhe objektivat e rrezikuara janë përmbushur.

Monitorimi evidenton gjithashtu, cilat risqe janë më kërcënuese dhe cilat janë pakësuar. Në këtë mënyrë jo vetëm garantohet transparenca dhe përgjegjshmëria për aktivitetet e ILD, por gjithashtu, raportimi sistematik mbi statusin e risqeve i mundëson menaxhimit të institucionit të dallojë prioritetet në trajtimin e risqeve.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë uljen e risqeve në mënyrë që të arrihen objektivat dhe që përcillen për zbatim me vendim të Titullarit të Institucionit. Gjatë zbatimit të këtyre aktiviteteve, drejtuesit duhet të marrin parasysh përfitimet e pritshme, si edhe koston për zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të futen në procese dhe sisteme që në kohën e ngritjes së këtyre proceseve dhe sistemeve. Futja e tyre në fazë të mëvonshme, është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Futja e aktiviteteve të kontrollit të përshtatshëm sjell reduktimin apo pakësimin e riskut, dhe konkretisht nëpërmjet:

- **Kontrolleve parandaluese**, të projektuara për të reduktuar mundësinë që risku të ndodhë/mundësinë e një rezultati të padëshiruar (si p.sh ndarja e detyrave, kufij të qartë të delegimeve të autorizuar etj.)
- **Kontrolleve korigjuese**, të projektuara për të korigjuar rezultatet e padëshirueshme (si p.sh kur tërhiqen pagesat e kryera gabimisht). Këto kontrolle japin mënyrat për rekuperimin e humbjeve ose dëmeve.
- **Kontrolleve drejtuese**, të projektuara për të garantuar arritjen e një rezultati të caktuar (si p.sh masat e sigurisë).
- **Kontrolleve zbuluese**, të projektuara për të zbuluar apo identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (p.sh kontrolle të aktiveve, apo procedurat e rakordimit). Këto kontrolle kryhen pasi një ngjarje të ketë ndodhur dhe duhet ulur risku i pasojave të padëshiruara, pasi ato mundësojnë marrjen e veprimeve riparuese. Disa kontrolle zbuluese shërbejnë për marrjen e informacionit, ato shoqërojnë procesin dhe japin alarmin në rast të shmangieve nga plani ose vlerat standarte. Kontrollet zbuluese përdoren për të përmirësuar procedurat ose kontrollet parandaluese.

Çdo masë kontrolli shoqërohet me një kosto dhe është e rëndësishme të justifikojë vlerën e parave në raport me riskun që kontrollon. Në terma të përgjithshëm, qëllimi i kontrollit është të kufizojë riskun.

Kontrollet duhet të përshkruhen në Regjistrin e Riskut, ku të përfshihet struktura apo personi përgjegjës për kontrollin.

Së fundmi, procesi i monitorimit duhet të sigurojë që:

- Të gjithë aspektet e procesit të menaxhimit të riskut rishikohen të paktën një herë në vit.
- Vetë risqet i nënshtrohen rishikimit në një frekuencë të përshtatshme kohore (rishikim nga vetë menaxheri dhe rishikim/auditim të pavarur).
- Informimi i menaxhimit për risqet e reja ose për ndryshimet në risqet e identifikuar, për të siguruar adresimin mënyrën e duhur.

Monitorimi dhe raportimi në vazhdimësi ndihmon të shihet nëse risqet janë menaxhuar me sukses, d.m.th nëse aktivitetet e kontrollit ulin realisht risqet përkatëse dhe nëse objektivat e rrezikuara prej këtyre risqeve janë përmbushur. Ato gjithashtu do të vënë në dukje, nëse risqet janë zmadhuar ose zvogëluar.

Në këtë mënyrë, sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për veprimatrinë e ILD dhe raportet e rregullta mbi statusin e risqeve duke i dhënë mundësi drejtuesve të Institucionit të vendosin përparësitë në reagimin ndaj risqeve.

3. Rolet dhe Përgjegjësitë Menaxheriale, sipas Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Titullari i ILD, është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda Institucionit dhe për aprovimin e nivelit të tolerimit të riskut.

Koordinatori i riskut të ILD, referuar kërkesave të nenit 10, të ligjit nr.10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, është nëpunësi autorizues, i cili është përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e planit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si edhe këshillimin dhe mbështetjen për mënyrën e zbatimit dhe zhvillimit të tij
- Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të ILD dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut;
- Përgatitjen dhe paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të ILD tek Grupi i Menaxhimit Strategjik
- Monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të ILD,
- Bashkërendimin e aktiviteteve gjatë procesit të vlerësimit mbi bazën e pyetësorit të vetvlerësimit, si edhe përgatitjen e deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në përputhje me Udhëzimin nr.28, datë 15.12.2021 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike”,

Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i ILD, i cili vepron si strukturë ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit, përfshirë kuadrin e menaxhimit të riskut.

GMS, krahas politikave dhe problematikave të zhvillimit, verifikon se si janë menaxhuar risqet brenda institucionit dhe përgatit një raport vjetor lidhur me këtë, duke shqyrtuar dhe vlerësuar regjistrin e riskut të hartuar nga çdo njësi/drejtori dhe miratuar nga Titullari i Institucionit, nëse risqet janë identifikuar drejt, janë kontrolluar, pakësuar apo zbutur në një mënyrë konsistente, duke propozuar ndërkohë përmirësimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të ILD.

Gjithashtu, GMS analizon dhe mbështet stafin drejtues të ILD në drejtim të zhvillimit efektiv, implementimit dhe rishikimit të strategjisë së menaxhimit të riskut, për të ndarë përvojat e menaxhimit të riskut në të gjitha hallkat e institucionit, ndihmon në pikëzimin dhe dhënien e përparësive të risqeve të identifikuara, si edhe raporton tek Titullari mbi gjithçka ndodh gjatë procesit. Është e nevojshme që në vazhdimësi të paraqitet një material për identifikimin e risqeve të reja dhe ndryshimin e prioritetëve dhe metodologjive zbutëse të risqeve të identifikuara. Për këtë qëllim, në Regjistrin e Riskut paraqiten risqet prioritare që i korrespondojnë objektivave strategjike.

Drejtimesit e drejtorive, krahas monitorimit dhe kontrollit të risqeve brenda njësive që drejojnë, duhet të raportojnë tek koordinatori i riskut të ILD mënyrën e menaxhimit të risqeve.

GMS duhet të marrë në konsideratë regjistrat e riskut për secilën drejtori dhe të verifikojë nëse risqet janë identifikuar saktë, janë listuar, kontrolluar dhe zbutur në një mënyrë konsistente, duke propozuar ndërkohë përmirësimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucion.

4. Menaxhimi i riskut dhe disa drejtime kryesore ku duhet fokusuar vëmendja

Menaxhimi i riskut njihet ndërkombëtarisht si praktikë e mirë, jo vetëm në administratën publike por në të gjithë sektorët e ekonomisë, për t'u fokusuar në menaxhimin e riskut si çelësi në suksesin e institucionit në përmbushjen e detyrimeve të tij, duke mbrojtur interesin e palëve të interesuara.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut konsiderohet gjithashtu, një komponent i rëndësishëm i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ndër drejtimet kryesore ku duhet fokusuar vëmendja në menaxhimin e riskut, rendisim:

a. Sistemet e menaxhimit financiar

Menaxhimi financiar është fusha ku risku i shpërdorimit të pronës dhe fondeve publike, si edhe rastet e korrupsionit janë më të pranishëm, kryesisht në fushën e prokurimeve publike, në administrimin e shpenzimeve operative, në transaksionet financiare etj.

Menaxhimi financiar është fusha ku risku për hedhjen e të dhënave gabim në pasqyrat financiare apo kontabilitetet mund të jetë i pranishëm, kryesisht kur kryhen transaksione të veçanta dhe të pakryera më parë, ku hasen llogaritje jo të sakta e pagave dhe shpërblimeve, po kështu e dietave për stafin e ILD, për brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, duhet të pasqyrohet mosdorëzimi në kohë i pasqyrave financiare dhe jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi, humbja e dokumentave financiare ose e çdo informacioni origjinal e plotësues, të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga Sektori i Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

b. Investimet në përgjithësi

Këtu përfshihet jo vetëm zbatueshmeria e kuadrit ligjor, por edhe shkalla dhe cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar, por edhe operacional, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen dhe cilësinë e punimeve, pagesa jo në përputhje me gjendjen aktuale të punimeve, mbikqyrjen dhe marrjen në dorëzim të punimeve etj.

c. Niveli jo i plotë i njohurive dhe përdorimit të sistemeve të IT

Kjo bën që të ekspozohemi në një shkallë të lartë të riskut, pasi nuk arrijmë të përshtatemi dhe të përdorim sisteme të tilla që shpesh janë të detyrueshme. Gjithashtu, një numër jo i pakët i punonjësve të institucionit, përpunojnë informacionet e tyre në mënyrë manuale, këtu risku i gabimeve në llogaritje apo në të dhënat, shfaqet i lartë.

d. Dhënia e opinioneve të gabuara në raportet e auditimit

Në rastet kur grupet e auditimit në raportet e tyre japin opinione jo të drejta, mund të ketë një impakt negativ në reputacionin e institucionit, duke ulur besueshmërinë e tij.

e. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Mangësitë në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil, sidomos në rekrutimin e punonjësve, ngritjen në detyrë, gjithashtu mangësitë në kualifikimin dhe trajnimin e tyre, ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e punës së stafit të ILD. Po kështu, largimet nga puna pa shkaqe të arsyeshme të stafit nëpunës, qarkullimi i shpeshtë i tyre dhe niveli i pamjaftueshëm profesional, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës të secilit punonjës.

f. Transparenca dhe komunikimi me median dhe publikun

Mosdhënia e informacionit të plotë, të saktë dhe në kohë mediave të ndryshme dhe publikut në përgjithësi, komunikim i dobët, moskthimi i përgjigjeve, mungesa e sqarimeve për kërkesat apo ankesat që publiku dërgon në ILD për çështje të ndryshme, dëmton reputacionin e institucionit, duke ulur besueshmërinë e tij.

Një menaxhim i mirë i risqeve i mundëson ILD, të përmbushë objektivat e mëposhtme:

- Të rrisë konfidencën në përmbushjen e rezultateve të dëshiruara.
- Të zbusë kërcënimet në mënyrë të efektshme dhe në nivel të pranueshëm.
- Të ndër marrë vendime të informuara rreth shfrytëzimit të shanseve.

5. Objektivat me risk të ILD

Risqet e mundshme të ILD, të cilat mund të ndikojnë në mosrealizimin e objektivave kryesore të përcaktuara në PBA 2023-2025, listohen si më poshtë:

Viti 2023

Objektivi: Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane, risqet e mundshme të identifikuar, janë:

- Risku i mundësisë së mosrespektimit të afateve kohore që nevojiten për kryerjen e procedurës së hetimit disiplinor (të përcaktuar në ligj - 6 muaj/më shumë) për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në pozicionet “Inspektor magjistrat” të strukturës së miratuar. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet paraqitjes së kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP, si dhe përmes kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kriteret hyrëse në njësinë e inspektorëve.
- Risku i mungesës së fondeve për organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera që i shërbejnë këtij objektivi. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*” dhe është planifikuar të shmanget nëpërmjet parashikimit të fondeve në kërkesat buxhetore të PBA 2023-2025, si dhe përmes bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare të cilat kanë ndihmuar ILD në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Objektivi: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, risqet e mundshme të identifikuar, janë:

- Risku i mungesës së fondeve për ngritjen e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve dhe dokumenteve që i shërben këtij objektivi. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”; është planifikuar të shmanget nëpërmjet përfshirjes në kërkesat për financim nga donatorë të huaj të fondit të nevojshëm.
- Risku i mungesës së infrastrukturës së përshtatshme në dhomën e serverit për krijimin e kushteve normale të punës. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”, dhe është planifikuar të shmanget nëpërmjet përfshirjes në projekt-preventivin e rishikuar të rikonstruksionit të ambienteve të godinës së ILD.
- Risku për ndërhyrje të paautorizuara dhe të dëmshme në infrastrukturën e TIK të ILD, nga sulme të brendshme, apo të jashtme të qëllimshme ose jo. Ky risk është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet, përmirësimit të sigurisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit. Dhënia e të drejtës së përdorimit me autorizim nga eprorët. Trajnimi i stafit të IT.

Viti 2024

Objekтиви: Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane, risqet e mundshme të identifikuara, janë:

- Risku i mundësisë së mosrespektimit të afateve kohore që nevojiten për kryerjen e procedurës së hetimit disiplinor (të përcaktuar në ligj - 6 muaj/më shumë) për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në pozicionet “Inspektor magjistrat” të strukturës së miratuar. Ky risk, është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet paraqitjes së kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP, si dhe përmes kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kriteret hyrëse në njësinë e inspektorëve.
- Risku i mungesës së fondeve për organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera që i shërbejnë këtij objekтиви. Ky risk, është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve” dhe është planifikuar të shmanget nëpërmjet parashikimit të fondeve në kërkesat buxhetore të PBA 2023-2025, si dhe përmes bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare të cilat kanë ndihmuar ILD në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Objekтиви: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, risqet e mundshme të identifikuara, janë:

- Risku i mungesës së fondeve për ngritjen e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve dhe dokumenteve që i shërben këtij objekтиви. Ky risk, është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve”; është planifikuar të shmanget nëpërmjet përfshirjes në kërkesat për financim nga donatorë të huaj të fondit të nevojshëm.
- Risku i mungesës së infrastrukturës së përshtatshme në dhomën e serverit për krijimin e kushteve normale të punës. Ky risk, është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve”, dhe është planifikuar të shmanget nëpërmjet përfshirjes në projekt-preventivin e rishikuar të rikonstruksionit të ambienteve të godinës së ILD.
- Risku për ndërhyrje të paautorizuara dhe të dëmshme në infrastrukturën e TIK të ILD, nga sulme të brendshme, apo të jashtme të qëllimshme ose jo. Ky risk është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet, përmirësimit të sigurisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit. Dhënia e të drejtës së përdorimit me autorizim nga eprorët. Trajnimi i stafit të IT.

Viti 2025

Objekтиви: Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane, risqet e mundshme të identifikuara, janë:

- Risku i mundësisë së mosrespektimit të afateve kohore që nevojiten për kryerjen e procedurës së hetimit disiplinor (të përcaktuar në ligj - 6 muaj/më shumë) për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në pozicionet “Inspektor magjistrat” të strukturës së miratuar. Ky risk, është pasqyruar edhe në “Planin e masave për minimizimin e risqeve”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet

paraqitjes së kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP, si dhe përmes kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kriteret hyrëse në njësinë e inspektorëve.

- Risku i mungesës së fondeve për organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera që i shërbejnë këtij objekti. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*” dhe është planifikuar të shmanget nëpërmjet parashikimit të fondeve në kërkesat buxhetore të PBA 2023-2025, si dhe përmes bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare të cilat kanë ndihmuar ILD në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Objekti: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, risqet e mundshme të identifikuar, janë:

- Risku i mungesës së fondeve për përmirësimin e infrastrukturës Teknologji-Informacioni nëpërmjet një platforme zhvillimi me pajisje elektronike. Ky risk, është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”; është planifikuar të shmanget nëpërmjet përfshirjes në kërkesat për financim nga donatorë të huaj të fondit të nevojshëm.
- Risku për ndërhyrje të paautorizuara dhe të dëmshme në infrastrukturën e TIK të ILD, nga sulme të brendshme, apo të jashtme të qëllimshme ose jo. Ky risk është pasqyruar edhe në “*Planin e masave për minimizimin e risqeve*”, është planifikuar të shmanget nëpërmjet, përmirësimit të sigurisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit. Dhënia e të drejtës së përdorimit me autorizim nga eprorët. Trajnimi i stafit të IT.

6. Regjistri i Riskut

Regjistri i riskut për ILD është element kryesor në zbatimin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të shihet dhe të trajtohet si një dokument, i cili duhet të rishikohet, përditësohet dhe të zhvillohet vit pas viti. Gjithashtu, ai duhet të jetë pjesë e diskutimeve të hartimit të PBA-së, pasi menaxhimi i riskut i ka fillesat në planifikimin buxhetor dhe siguron lidhjen e buxhetit me realizimin e objektivave, si edhe matjen e performancës së aktiviteteve gjatë procesit të kontrollit për realizimin e tyre.

Është e nevojshme që në vazhdim të paraqitet një material për identifikimin e risqeve të reja dhe ndryshimin e prioriteteve dhe metodologjive zbutëse të risqeve të identifikuar.

Për këtë qëllim, në regjistrin e riskut të institucionit, nga çdo njësi duhet të paraqiten risqet prioritare që i korrespondojnë objektivave strategjike.

Nëse prezantohen objektiva të reja, këto ka të ngjarë të jenë të lidhura me risqe të reja.

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQVEVE NË ZYRËN E ILD 2023-2025

Nr.	Emërtimi i objektivit	Përshkrimi i riskut	Niveli i riskut	Aktivitetet për minimizimin e risqeve	Struktura përgjegjëse	Afati për realizimin e aktivitetit	Statusi i realizimit	Komente	Lidhja me aktivitete të tjera
1	Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.	Mungesa e kapaciteteve të ILD-së, Inspektorëve në veçanti dhe ndihmesinpektorëve sipas strukturës të miratuar të ILD-së	I Mesëm	Trajnimi i personelit në fushën e menaxhimit të riskut.	SBNJ	Në vijimësi 2023-2025			

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQVE NË ZYRËN E ILD 2023-2025

2	Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.	Risku i mundësisë së mosrespektimit të afateve kohore që nevojiten për kryerjen e procedurës së hetimit disiplinor (të përcaktuar në ligj - 6 muaj/më shumë) për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në pozicionet "Inspektor magjistrat" të strukturës së miratuar	I Lartë	Paraqitja e kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP	ILD/SP/ DHASHJ	Në vijimësi 2023-2025			

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQEVË NË ZYRËN E ILD 2023-2025

3	Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.	Risku i mundësisë së mosrespektimit të afateve kohore që nevojiten për kryerjen e procedurës së hetimit disiplinor (të përcaktuar në ligj - 6 muaj/më shumë) për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në pozicionet “Inspektor magjistrat” të strukturës së miratuar	I Lartë	Përtëritja e kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kriteret hyrëse në njësinë e inspektorëve	ILD/SP/ DHASHJ	2023-2024			

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQVE NË ZYRËN E ILD 2023-2025

4	Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	Risku i mungesës së fondeve për ngritjen e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve dhe dokumenteve që i shërben këtij objektivi	I Lartë	Hartimi i kërkesës për financim nga donatorë të huaj të fondit të nevojshëm për ngritjen e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve dhe dokumenteve	Anëtarët e GP/ STI	Mars 2024			

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQVEVE NË ZYRËN E ILD 2023-2025

5	Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	Risku i mungesës së infrastrukturës së përshtatshme në dhomën e serverit për krijimin e kushteve normale të punës	I Lartë	Përfshirja në projekt-preventivin e rishikuar të rikonstruksionit të ambjenteve të godinës së ILD për ndërtimin e ambjenteve dhe infrastrukturës së përshtatshme në dhomën e serverit për krijimin e kushteve normale të punës	SP/EMP/DES HM, struktura e IT-së	2023-2024			
6	Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së	Risku për ndërhyrje të paautorizuara dhe të dëmshme në infrastrukturën e	I Lartë	Dokumentim i nevojave për përmirësimin e infrastrukturës Teknologji-	DESHM, struktura e IT-së	Në vijimësi 2023-2025			

PLANI I VEPRIMIT PËR MINIMIZIMIN E RISQEVE NË ZYRËN E ILD 2023-2025

	informacioni t për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	TIK të ILD, nga sulme të brendshme, apo të jashtme të qëllimshme ose jo		Informacioni nëpërmjet një platforme zhvillimi me pajisje elektronike					
--	----------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------	--	-----------------------------------------------------------------------	--	--	--	--	--